

KODI I ETIKËS PËR PUNONJËSIT E INSPEKTORATEVE SHTETËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Kodi i etikës është tërësia e të drejtave, detyrimeve dhe rregullave të sjelljes që çdo punonjës i inspektorateve shtetërore duhet të përmbushë gjatë ushtrimit të profesionit të tij në marrëdhënie me kolegët dhe ndaj çdo personi të jashtëm.

Punonjësit e inspektorateve shtetërore, gjatë ushtrimit të funksioneve e detyrave duhet të reflektojnë përkushtim profesional, standarte të larta të ndershmërisë dhe respektim korrekt të akteve ligjore dhe nënligjore, me qëllim ruajtjen dhe forcimin e besimit tek subjektet e inspektimit.

Bazuar në misionin kryesor të inspektorateve shtetërore, për mbrojtjen e interesit publik dhe interesave të ligjshme të personave fizikë dhe juridikë, është hartuar Kodi i Etikës i cili pasqyron vlerat, sjelljen dhe qëndrimin e çdo punonjësi të inspektorateve shtetërore në marrëdhënie me njëri-tjetrin dhe me subjektet e inspektimit.

Kodi i etikës zbatohet për të ndërgjegjësuar dhe për të rritur nivelin e përkushtimit të punonjësit të inspektoratit shtetëror, për të patur një staf të besueshëm dhe me aftësitë e duhura profesionale, i cili di të dëgjojë, mësojë dhe të veprojë me sinqeritet e besueshmëri për mbarëvajtjen e punës.

Punonjësit e inspektorateve shtetërore, për të përmbushur detyrat funksionale, duhet të jenë në gjendje të argumentojnë vendimet e tyre, qofshin këto pozitive ose negative.

Duke jetuar në një shoqëri të hapur dhe transparente është e nevojshme dhe e rëndësishme që të gjithë punonjësit të marrin përgjegjësitë e tyre.

MISIONI

Çdo punonjës i inspektorateve shtetërore duhet të punojë i orientuar nga pasioni dhe i drejtuar nga profesionalizmi, si pjesë e stafit të inspektoratit përkatës, i cili nxit konsolidimin e sjelljeve dhe të vlerave etike të çdo punonjësi gjatë ushtrimit të funksionit.

QËLLIMI DHE FUSHA E VEPRIMIT

Qëllimi i këtij Kodi Etike është promovimi i marrëdhënieve etike për punonjësit e inspektorateve shtetërore, duke krijuar një vijë të drejtë komunikimi dhe sjellje, gjatë dhe jashtë ushtrimit të kompetencave dhe detyrave funksionale konform akteve ligjore dhe nënligjore.

Rregullat e përcaktuara në këtë Kod do të zbatohen për të gjithë dhe nga të gjithë punonjësit e inspektorateve shtetërore gjatë dhe jashtë ushtrimit të funksionit. Kudo që përmendet termi “punonjës” do të nënkuptohen punonjësit e të gjitha niveleve të inspektoratit shtetëror sidomos ata që gëzojnë statusin e inspektorit. Kudo që përmenden inspektoratet shtetërore do të nënkuptohet edhe Inspektorati Qendror.

1. RREGULLA TË PËRGJITHSHME

Të gjithë punonjësit e inspektorateve shtetërore duhet të kenë të qartë se është detyra e tyre të respektojnë rregullat e etikës dhe në veçanti:

- të kryejnë detyrën e tyre me përkushtim të plotë dhe ndershmëri;
- të respektojnë me rigorozitet rregullat e etikës dhe të mos mjaftohen me zbatimin minimal të normave që përcaktohen në dispozitat ligjore ose në procedurat në fuqi;
- të lexojnë dhe të kuptojnë rregullat e etikës si dhe të dijnë pasojat nëse ato nuk zbatohen;
- të zbatojnë ligjet, rregulloret, vendimet dhe instruksionet që kanë të bëjnë me zbatimin e detyrave të ngarkuara;
- të trajtojnë kolegët dhe publikun me mirsjellje, të njohin të drejtat si dhe detyrat e tyre;
- të evitojnë shpërdorimin ose keqpërdorimin e burimeve publike;
- të mos nxjerrin përfitim në mënyrë të paligjshme ose të mos përpiqen të shfrytëzojnë për përfitim personal informacionet zyrtare me të cilat ata njihen gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre;
- të sillen në mënyrë të tillë që të ruajnë dhe përmirësojnë imazhin dhe statusin e inspektoratit shtetëror përkatës.

2. PARIMET E PËRGJITHSHME

Punonjësit e inspektorateve shtetërore, duke pasur parasysh interesin e përgjithshëm të funksionit që kryejnë, duhet të sillen në mënyrë të tillë që të ruajnë dhe të nxisin besimin tek subjektet e inspektimit dhe në publik.

Punonjësit e inspektoratave shtetërore duhet të respektojnë këto parime bazë:

2.1. Korrektësia

2.1.1. Respektimi i ligjit - Të gjithë punonjësit e inspektorateve shtetërore duhet të respektojnë ligjin dhe të kryejnë detyrat, në përputhje me legjislacionin në fuqi duke mos penguar zbatimin e politikave të inspektimit dhe vendimeve ose veprimeve ligjore të autoriteteve të inspektorateve shtetërore, Inspektoratit Qendror dhe autoriteteve të tjera publike.

2.1.2. Vetëkontrolli dhe kontrolli i varësisë – funksionon si një mekanizëm optimal i cili rregullon dhe verifikon realizimin e procedurave që duhet të ndjekë çdo punonjës.

2.1.3. Punonjësit e inspektorateve shtetërore duhet të respektojnë marrëdhëniet hierarkike me eprorët, vartësit e kolegët e të njëjtit nivel hierarkik, në funksion të arritjes së qëllimit të përbashkët dhe marrëdhënieve korrekte me subjektet e inspektimit.

2.1.4. Punonjësit e inspektorateve shtetërore respektojnë mendimin e kolegëve, përveç rasteve që bien në kundërshtim me ligjet në fuqi dhe japin opinione sa herë që i kërkohet për çështje dhe detyra sipas funksionit, duke bashkëpunuar nëpërmjet dialogut dhe diskutimeve të hapura.

2.2. Përgjegjshmëria

Punonjësit e inspektorateve shtetërore duhet të përdorin autoritetin në mënyrë të përgjegjshme, pasi përveç përgjegjesisë administrative kanë edhe përgjegjësi penale. Çdo punonjës e konsideron veten të përgjegjshëm në përputhje me funksionin ose detyrën që kryen dhe duhet të ketë aftësinë të jetë i kuptueshem, i besueshëm, i hapur dhe transparent në marrëdhënie me njëri-tjetrin dhe subjektet e inspektimit. Punonjësit e inspektorateve shtetërore në kryerjen dhe përmbushjen e detyrave të ngarkuara me profesionalizëm, aplikojnë njohuritë, aftësitë dhe eksperiencën e duhur.

2.3. Pavarësia

2.3.1. Integriteti – Punonjësit e inspektorateve shtetërore nuk duhet të influencohen nga interesi i tyre ose i të tjerëve në gjykimin me profesionalizëm në realizimin e detyrave të ngarkuara, por duhet të ushtrojnë të drejtën dhe të kenë besim për t'u mbështetur në aftësitë dhe gjykimin e tyre.

2.3.2. Objektiviteti – Punonjësit e inspektorateve shtetërore, duhet të mbështeten tek baza ligjore për mbledhjen, vlerësimin, gjykimin dhe komunikimin e informacioneve dhe nuk influencohen nga interesi i tyre ose i të tjerëve në formimin e gjykimit.

2.3.3. Ndershmëria – është një element bazë për të arritur sukses e për të patur një gjykim e vlerësim të drejtë. Duhet të aplikohen në mënyrë rigorozë parimet e barazisë, të drejtësisë dhe të moralit në realizimin e detyrave, duke parandaluar çdo sjellje që ka të bëjë me akte korruptive dhe shpërdorim të detyrës.

2.4. Trajtimi i barabartë

Punonjësit e inspektorateve shtetërore duhet të trajtojnë me respekt subjektet e inspektimit dhe të tregojnë kujdes në procedurën e inspektimit, duke patur parasysh të drejtat dhe detyrimet e tyre në përputhje me ligjin. Të gjithë subjektet e inspektimit duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë, duke parandaluar çdo qëndrim diskriminues, si dhe çdo sjellje që mund të ngjallë dyshime në kryerjen e shërbimeve ndaj tyre dhe atyre publike.

2.5. Konfidencialiteti

2.5.1. Përdorimi i informacioneve vetëm për qëllime profesionale – Çdo punonjës i inspektorateve shtetërore, i cili mund të ndeshet me të dhëna personale dhe konfidenciale të subjekteve të inspektimit e kolegëve, duhet t'i përdorë ato vetëm nëse i nevojiten për realizimin e detyrave funksionale. Këto të dhëna nuk duhet të ndahen me personat e familjes apo edhe me të tjerët. Punonjësit e inspektorateve shtetërore respektojnë vlerën e informacionit që marrin dhe nuk e bëjnë atë publik pa autorizimin përkatës, përveç rasteve kur ka detyrim ligjor për ta bërë atë. Ata duhet të ruajnë informacionin e mbledhur për shkak të detyrës funksionale apo detyrës së ngarkuar dhe nuk duhet ta përdorin atë për përfitim personal ose në kundërshtim me ligjin dhe rregullat e etikës, me qëllim rritjen e besimit tek subjektet e inspektimit.

2.5.2. Ruajtja e informacionit - Përveç detyrimit për të ruajtur fshehtësinë, çdo punonjës është përgjegjës për parandalimin dhe marrjen e masave për mbrojtjen e informacionit si nga kolegët ashtu edhe nga persona të jashtëm. Informacioni dhe të dhënat konfidenciale nuk duhet të lihen në vendin e punës të pambrojtur dhe duhet të marrin masat e nevojshme që të respektohen detyrimet e përcaktuara në ligj për moszbulimin apo publikimin e informacionit jopublik.

2.5.3. Detyrimi i rezervimit – Çdo punonjës gëzon lirinë e opinionit personal, por duhet të ketë parasysh ruajtjen e konfidencialitetit jo vetëm në qendrimet apo deklaratat me mediat e shkruara dhe elektronike, por edhe gjatë gjithë kohës së ushtrimit të funksionit.

2.6. Ndershmëria përpara ligjit dhe moralit

Është një ndër parimet bazë i cili ka për qëllim të informojë punonjësin e inspektoratit shtetëror përkatës për detyrimin e ruajtjes së sekretit profesional, respektimin e moralit dhe të drejtësisë, për të siguruar transparencë e objektivitet në dhënien e informacionit për vendimet e marra nga ana e inspektorateve shtetërore dhe Inspektoratit Qendror. Suksesi i të qenit korrekt ndaj ligjit dhe i virtytshëm ndaj moralit nuk qëndron në sanksionimin e punonjësit të inspektoratit shtetëror, por në marrjen e masave për parandalimin e shpërdorimit të detyrës.

2.6.1. Ndershmëria përpara ligjit – për të përmbushur misionin e administratës, detyra e çdo punonjësi të inspektoratit shtetëror është të jetë i përgjegjshëm dhe të përdorë standarde të njëjta në zgjidhjen e shpejtë të praktikave ligjore.

2.6.2. Ndershmëria përpara moralit – ndershmëria qëndron në krye të rregullave morale. Të gjithë punonjësit e inspektorateve shtetërore duhet të jenë të vetëdijshëm se detyra kryesore dhe më e rëndësishme është që të meritojnë respektin e subjekteve të inspektimit.

2.6.3. Nëse punonjësi i inspektoratit shtetëror, për arsye të shkeljeve të konstatuara gjatë kryerjes së detyrave, është njoftuar nga Prokuroria për fillimin e hetimit të një çështje penale ndaj tij, atëherë ai duhet që brenda 24 orëve pas marrjes së njoftimit të vërë në dijeni eprorin e tij si edhe drejtorinë përkatëse që mbulon burimet njerëzore pranë inspektoratit shtetëror përkatës.

3. RREGULLAT E SJELLJES, PARAQITJA

Punonjësit e inspektorateve shtetërore duhet të kenë një sjellje të mirë dhe të denjë në të gjitha rrethanat, me qëllim respektimin e moralit dhe drejtësisë gjatë ushtrimit të funksionit.

3.1. Paraqitja

Punonjësit e inspektorateve shtetërore duhet të paraqiten me veshje serioze, për të respektuar autoritetin institucional në marrëdhënie ndërmjet kolegëve dhe me subjektet e inspektimit. Paraqitja fizike duhet të vlerësohet me seriozitet maksimal nga vetë punonjësi, pasi influencon në krijimin e imazhit të institucionit që përfaqëson tek subjekti i inspektimit dhe publiku.

3.2. Identifikimi i punonjësit

Gjatë ushtrimit të detyrës punonjësit e inspektorateve shtetërore duhet të mbajnë në mënyrë të ekspozuar kartën e inspektorit (në rastin e atyre punonjësve që gëzojnë statusin e inspektorit) ose kartën e punonjësit. Bëhet përjashtim nga ky rregull kur mbajtja e këtij dokumenti çënon sigurinë e tyre.

3.3. Konsumi i pijeve alkoolike dhe duhanit

Punonjësit e inspektorateve shtetërore nuk duhet të pijnë duhan gjatë procedurës së inspektimit në vendin e inspektimit dhe nuk mund të konsumojnë pije alkoolike, dhe çdo substance e cila influencon në cilësinë e punës dhe në sjelljen e tyre.

3.4. Respektimi i orarit të punës

Punonjësit e inspektorateve shtetërore duhet të respektojnë dhe zbatojnë me efektivitet orarin e punës. Rastet e mosparaqitjes në detyrë, duhet të shoqërohen me justifikim të arsyeshëm.

3.5. Paanësia, mosdiskriminimi dhe ngacmimi

Çdo punonjës duhet të kujdeset që brenda dhe jashtë ambjentëve të punës të mos shfaqë sjellje të diskriminimit dhe ndëshkimit për arsye race, besimi, gjinie etj., me qëllim garantimin e sjelljes etike me drejtësi, paanshmëri, ndershmëri, integritet e profesionalizëm të të gjithë zyrtarëve të inspektorateve shtetërore.

Asnjë punonjës nuk duhet që për shkak të detyrës të vuajë reagime morale apo seksuale që mund të jenë objekt ose pasojë, të cilat kanë si qëllim çënimin e të drejtave dhe dinjitetit të tij, jo vetëm nga eprori por edhe nga kolegë ose vartës. Ngacmimet individuale apo në grup, që kryhen në kuadër të përfitimit moral apo seksual, dëmtojnë shëndetin fizik, mendor dhe të ardhmen profesionale të çdo inspektori dhe punonjësi.

3.6. Ruajtja e pronës publike

Punonjësit duhet të jenë të kujdesshëm në përdorimin e mjeteve dhe pronës së institucionit. Nuk duhet të përdorin mjetet institucionale për qëllime personale apo për përdorim privat. Duhet të evitojnë shpërdorimin dhe keqpërdorimin e burimeve dhe mjeteve të institucionit.

4. AMBIENTI I PUNËS

4.1. Rregulla të përgjithshme

Të gjithë punonjësit e inspektorateve shtetërore kanë të drejtë të ushtrojnë aktivitetin e tyre në kushte sa më të mira shëndeti dhe sigurie pa qenë objekt i diskriminimit dhe në një ambient ku objektivat e caktuara ndaj gjithsecilit nga inspektorati shtetëror të mund të arrihen. Një ambient profesional mund të gjykohet:

- Kur ai është i drejtë dhe i përshtatshëm;
- Kur është i sigurt dhe i jep mbështetjen nëpunësit;
- Kur nuk konsumohet në të alkool;
- Kur nuk ka diskriminim ose dhunim të pajusfikuar;

- Kur konsiderohen si vlerë ndryshimet midis individëve dhe diversitetit të kulturave;
- Kur informon në mënyrë të paanshme nëpunësit për rezultatet e tyre dhe i lejon të përmirësohen;
- Kur përpiqet të terheq pjesëmarrjen e personelit në vendimet që merren.

4.2. Paania dhe mosdiskriminimi

Eshtë parësore që inspektoratet shtetërore të angazhohen për të vepruar në një mënyrë korrekte dhe pa bere diskriminime me qëllim që të garantojnë barazinë, zbatimin e rregullave të etikës dhe ndjenjën e përgjegjësisë. Çdo punonjës duhet të kujdeset në menyrë aktive që në ambientet e punës të mos ketë diskriminim ose ndëshkim.

4.3. Shëndeti dhe siguria

Punonjësit e inspektorateve shtetërore kanë të drejtë të ushtrojnë aktivitetin e tyre në ambiente të shëndetshme dhe të sigurta. Ata duhet t'i marrin me shumë seriozitet përgjegjësitë që kanë të bëjnë me çështjet e sigurisë dhe duhet t'i raportojnë menjëherë eprorit të drejtpërdrejtë për çdo problem shëndeti dhe sigurie që mund të lind nga shkelja e rregullave në fuqi.

5. PËRKUSHTIMI DHE AFTËSITË

5.1. Punonjësit e inspektorateve shtetërore duhet të kryejnë detyrën me përkushtim, ndershmëri, dhe përgjegjësi, konformë akteve ligjore. Nëpërmjet rritjes së njohurive dhe aftësive profesionale, do të përfitojnë aftësi të mira dëgjuese, vlerësuese e komunikuese si me kolegët ashtu edhe me subjektet e inspektimit. Aftësitë profesionale të përfituara duhet të vihen në funksion të zbatimit të detyrave dhe eprorët direkt bëjnë periodikisht vlerësimin e tyre sipas legjislacionit në fuqi.

5.2. Në rast se punonjësi krijon vështirësi serioze në ushtrimin e profesionit të tij edhe pas një periudhe gjatë së cilës ai ka patur mundësi formimi profesional atëherë ky punonjës gjendet përpara një paaftësie profesionale. Ndërsa në rast se punonjësi është i paaftë të realizojë funksionin që i është besuar dhe e neglizhon atë në mënyrë të vullnetëshme, atëherë ai ndodhet përpara një neglizhimi profesional. Të dyja këto raste janë objekt i shkeljeve disiplinore.

6. MARRËDHËNIET ME SUBJEKTET E INSPEKTIMIT

6.1. Punonjësit e inspektorateve shtetërore në marrëdhënie me subjektet e inspektimit duhet të:

- mbajnë marrëdhënie korrekte institucionale duke ruajtur dhe zbatuar parimet e integritetit, objektivitetit, konfidencialitetit e kompetencës profesionale në funksion të realizimit e përmbushjes së detyrave të ngarkuara;
- ushtrojnë kompetencat e tyre për të këshilluar subjektet e inspektimit të plotesojnë detyrimet ligjore dhe të njohin e të vlerësojnë të drejtat që u jep ligji;

- komunikojnë me subjektet e inspektimit në mënyrë të paanshme, pa kryer veprimtari promovimi për ndonjë subjekt inspektimi apo me qëllim cënimin e tij dhe nuk lejojnë që edhe subjektet e inspektimit të veprojnë në të njëjtën mënyrë;
- të kenë parasysh paraqitjen zyrtare gjatë orarit të punës, komunikimi të përmbajë etikë, të jetë korrekt, kompetent dhe sa më i qartë për subjektet e inspektimit;
- respektojnë pozicionin e punës dhe të jenë të pavarur, duke mos pranuar asnjë udhëzim lidhur me performancën e detyrave brenda apo jashtë institucionit;
- raportojnë pranë eprorit të tyre, kur vlerësojnë se i është kërkuar të veprojnë në mënyrë të paligjshme, të pandershme në kundërshtim me etikën profesionale dhe njëkohësisht të sinjalizojë për çdo konstatim të shkeljeve ligjore gjatë ushtrimit të funksionit.

6.2. Punonjësit e inspektorateve shtetëore në marrëdhënie me subjektet e inspektimit nuk duhet të:

- përfshihen në çfarëdo veprimtari apo transaksion financiar me subjektet e inspektimit apo me përfaqësuesit e tyre ligjorë gjatë dhe jashtë ushtrimit të funksionit;
- marrin pjesë në aktivitete të cilat konsiderohen si konflikt interesi;
- rekomandojnë apo sugjerojnë tek subjektet e inspektimit ekspertë financiar apo ligjor për mbajtjen e dokumentave të tyre.

6.3. Ankesat ndaj inspektoratit shtetëror ose punonjësve të tij

Ka rëndësi që publiku të bindet për transparencën dhe ndershmërinë e punonjësve të inspektorateve shtetëore. Për të siguruar si dhe për të ruajtur këtë bindje, kur ka ankesa ndaj inspektorateve shtetëore ose ndaj punonjësve të tyre drejtuar Inspektoratit Qendror, duhet menjëherë të kryhet një hetim objektiv për këto ankesa.

6.4. Agresioni ndaj një punonjësi

Punonjësit e inspektorateve shtetëore, gjatë ushtrimit të funksionit të tyre, duhet të mendojnë për sigurinë personale si dhe të kolegëve të tyre. Kur gjykojnë se nuk duhet të ndërhyjnë vetë, duhet të kërkojnë përforcime nga organet e specializuara. Në këto raste kërkesa për ndërhyrje duhet t'i njoftohet eprorit më të afërt.

7. MARRËDHËNIET ME VEPRIMTARI JASHTË OBJEKTIT TË PUNËS

Inspektorët e inspektorateve shtetëore:

7.1. Nuk mund të ushtrojnë veprimtari private, që krijon të ardhura në formën e personit fizik tregtar, ortakëri personash fizikë, tregtarë të çdo forme, profesione të lira të avokatisë, noterisë, ekspertit të licencuar, si edhe të konsulentit, agjentit ose të përfaqësuesit të organizatave;

7.2. Mund të punësohen vetëm në detyra dhe funksione të mësimdhënies, pasi për këtë të ketë marrë pëlqimin e eprorit të drejtpërdrejtë dhe kryeinspektorit, bazuar në kërkesën me shkrim

e cila përmban përshkrimin e saktë të objektit, vendin (institucionin), kohëzgjatjen, shpeshhtësinë dhe pagesën.

7.3. Aktivitete me karakter publik

Punonjësit e inspektorateve shtetërore nuk duhet të bëjnë në publik komente të papërshtatshme mbi politikën dhe programet e inspektorateve shtetërore si më poshtë vijon:

- Vërejtje mbi politikën ose programe të inspektoratit shtetëror përkatës që i interesuari ka qenë i ngarkuar t'i hartojë ose t'i zbatojë;
- Deklaratat dhe opinionet personale që mund të interpretohen si zyrtare;
- Sulme kundër administratës së inspektoratit shtetëror përkatës që mund të çenojnë aktivitetin e tij;
- Kritika për politikën e inspektoratit shtetëror në fushën e funksioneve zyrtare të përfaqësimit;
- Sulme personale kundër kolegëve të administratës së inspektoratit shtetëror përkatës.

7.4. Aktivitete me karakter politik

7.4.1. Me qëllim që të mos çenohen marrëdhëniet midis punonjësve të inspektorateve shtetërore dhe publikut, i gjithë personeli i inspektorateve shtetërore ndalohej të bëjë gjatë orarit të punës propagandë politike.

7.4.2. Punonjësve të inspektorateve shtetërore u ndalohej:

- Mbajtja gjatë punës e shenjave të partive ose shoqatave politike;
- Shpërndarja e materialeve propagandistike në ambjentet e inspektorateve shtetërore apo subjekteve të inspektimit;
- Perdorimi i ambjenteve të punës për aktivitet politik;
- Diskutimi gjatë orarit të punës për tema politike;
- Pjesëmarrja me uniformë ose civil në manifestime të paautorizuara nga organet kompetente.

7.5. Menyra e sjelljes për çështje të vogla

7.5.1. Rregulla të përgjithshme

Punonjësit duhet të informojnë menjëherë kryeinspektorin përkatës kur kanë vështirësi financiare. Kjo është e vlefshme gjithashtu edhe për punonjësit që kanë vështirësi të mëdha financiare dhe nuk kanë mundësi të përballojnë menjëherë borxhet e tyre.

Punonjësit që kanë vështirësi financiare, në përgjithësi lejohen të ruajnë vendin e punës me përjashtim të rasteve kur kanë kryer një shkelje të rëndë duke prekur fondet publike apo duke u përfshirë në akte që mund të konsiderohen vepra penale dhe që dënohen me sanksione disiplinore ose penale. Punonjësit që kanë vështirësi financiare nuk duhet të vendosen në poste ku ata eventualisht mund të abuzojnë me fondet publike apo me detyrën.

7.5.2. Operacionet financiare me karakter privat

Nuk u këshillohet punonjësve të kryejnë midis tyre operacione financiare me karakter privat. Ky rekomandim vlen gjithashtu për dhënien e huave një kolegu ose garantimin e huamarrjeve.

Punonjësit që kryejnë operacione të kësaj natyre me koleget e tjerë të inspektoratit shtetëror përkatës e bëjnë nën përgjegjësinë e tyre personale, por ata duhet të kujdesen që këto operacione mos të dëmtojnë veprimtarinë dhe reputacionin e inspektoratit shtetëror.

8. KONFLIKTI I INTERESAVE

8.1. Për të shmangur konfliktin e dukshëm të interesit dhe rrezikun e përdorimit të gabuar të informacionit, është e nevojshme që punonjësit të këshillohen me drejtuesit.

8.2. Inspektorët e inspektorateve shtetërore, duhet të kenë parasysh se:

- nuk mund të zotërojnë, në mënyrë aktive, asnjë aksion ose pjesë në kapital në shoqëritë tregtare, që ushtrojnë veprimtari në fushën dhe territorin e juridiksionit të inspektoratit shtetëror përkatës, ku ushtron funksionet ky inspektor. Për inspektorët e inspektoratit shtetëror në nivel qendror, juridiksion territorial vlerësohet i gjithë territori i Republikës së Shqipërisë;
- nuk administrojnë, ndikojnë, orientojnë subjektin e inspektimit në veprimtarinë e tij si dhe nuk mund të inspektojnë subjektet e inspektimit të personave të lidhur me ta. Personi i lidhur me inspektorin janë vetëm bashkëshorti/ja, fëmijët në moshë madhore, prindërit e inspektorit e të bashkëshortit/es si dhe çdo person fizik ose juridik, i cili, në lidhje me dhuratën, favorin, premtimin ose trajtimin preferencial, luan rolin e ndërmjetësit a të shkëmbyesit të interesave të lindur nga ky veprim;
- nëse gjatë ushtrimit të funksionit, vëren se ka marrëdhënie të drejtpërdrejta apo të tërthortë me subjektin e inspektimit, duhet ta deklarojë paraprakisht atë tek eprori direkt;
- nuk marrin pjesë në ndonjë pjesëmarrje që cënon paanshmërinë e qëndrimit të tyre. Kjo pjesëmarrje përfshin ato aktivitete ose marrëdhënie të cilat mund të jenë në konflikt interesi me të qenit inspektor i inspektoratit shtetëror përkatës;
- kërkimi dhe pranimi i çdo burimi tjetër, për të përfituar shpërblim në këmbim të një shume financiare apo në formë dhurate, për shkak të pozicionit në inspektoratin shtetëror, është e papajtueshme dhe përbën shkak për fillimin e ecurisë disiplinore dhe kallëzim penal;
- plotëson me shkrim formularin e konfliktit të interesit dhe ia dorëzon atë eprorit direkt, para marrjes së detyrës për zbatim dhe kur mendon se lind një konflikt i mundshëm interesi.

9. APLIKUESHMËRIA DHE ZBATIMI I RREGULLAVE TË ETIKËS

9.1. Njohja dhe zbatimi me përpikmëri i rregullave etike të përcaktuara në këtë kod, është shumë i rëndësishëm për arritjen e objektivave nga të gjithë inspektorët, gjë e cila do të ndikojë në rritjen e autoritetit të inspektorateve shtetërore dhe të mirëbesimit në publik.

9.2. Fakti që një sjellje nuk është përmendur në këtë rregullore, nuk e pengon atë për t'u bërë e papranueshme dhe për këtë arsye inspektori i nënshtrohet masave disiplinore.

9.3. Moszbatimi i këtyre rregullave do të vlerësohet dhe ndiqet sipas procedurës së parashikuar nga aktet ligjore në fuqi.

10. PËRMBLEDHJE

10.1. Publiku kërkon që çdo punonjës i inspektorateve shtetërore të jetë i ndershëm, i paanshëm si dhe kompetent. Me qëllim që të ruhet besimi i publikut, ka shumë rëndësi që punonjësi i inspektoratit shtetëror të zbatojë në mënyrë shumë rigoroz rregullat e etikës kur ai kontakton me publikun, me subjektet e inspektimit ose me punonjësit/nëpunësit e tjerë të shtetit.

10.2. Respektimi i plotë dhe në tërësi i këtyre rregullave të etikës kërkon që çdo punonjës i inspektorateve shtetërore duhet:

- Të permbush funksionet e tij me kujdes, seriozitet dhe mirësjellje;
- Të përpiqet të zbatojë me maksimumin e seriozitetit rregullat e etikës duke mos u mjaftuar me respektimin minimal të tyre;
- Të silltet në vazhdimësi në një mënyrë të tillë që të ruajë ose përmirësojë imazhin e inspektoratit shtetëror përkatës;

10.3. Në veçanti drejtuesit kanë një rol të rëndësishëm për të luajtur, ata duhet të jenë të gatshëm:

- Të japin shembullin personal;
- Të kujdesen që personeli të njohë ligjet, udhëzimet dhe procedurat e inspektimit;
- Të marrin të gjitha masat e nevojshme kur personeli i tyre nuk zbaton rregullat në fuqi.

11. BAZA LIGJORE

- Ligji Nr. 10433 datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë",
- Ligji Nr. 7961 , date 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,
- Ligji Nr. 9131 datë 08.09.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike"
- Ligji Nr. 9367 datë 07.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" i ndryshuar
- Ligji Nr. 9049 datë 10.04.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve civil" i ndryshuar.

Këto rregulla hyjnë në fuqi menjëherë.

INSPEKTORE E PËRGJITHSHME

Mimoza HAJDARMATAJ